



Pranuar / Dorezuar Received / Delivered	14. 04. 2021	1	viti god year
Organ / Institucija Org. / Inst.	SKIPKSHICK	17833/2021	1/5



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.168/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.1043/20 të datës 05.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.133/2020 të datës 21.04.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rr. "Ismet Gashi", Nr.74 në Komunën e Prizrenit, kundër Vendimit me numër KA.nr.10/2020 të datës 02.04.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.04.2021, mori këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.133/2020 e datës 21.04.2020 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KA.nr.10/2020 i datës 02.04.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

### A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sipas autorizimit të lëshuar nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil pranë Ministrisë së Administratës Publike, me datë 16.09.2019 ka shpallur konkurs publik për rekrutimin e pozitës "Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional" Nr.05/2019 në Gjykatën Themelore në Prizren.

Komisioni Përzgjedhës i themeluar me Vendimin 03/208 të datës 18.02.2020, me datë 20.02.2020 ka përgatitur listën e shkurtër të kandidatëve në të cilën është përfshirë edhe ankuesi. Sipas shkresave të lëndës, testi me shkrim është mbajtur më datë 24.02.2020 ndërsa testi me gojë është mbajtur më datë 27.02.2020.

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, ka publikuar njoftimin për renditjen përfundimtare të kandidatëve, ku sipas këtij njoftimi, ankuesi nuk është përzgjedhur në pozitën e lartcekur, andaj i njëjti kundër këtij njoftimi, me datë 04.03.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 02.04.2020 ka nxjerr Vendimin me numër KA.nr.10/2020 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar dhe ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit Përzgjedhës, dhe si rrjedhojë njoftimin për renditjen përfundimtare të kandidatëve.

Ankuesi kundër Vendimit me numër KA.nr.10/2020 të datës 02.04.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 21.04.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 769/2020 të regjistruar me numër A.nr.133/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale dhe vendosjes në mënyrë jo meritore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas legjislacionit në fuqi, me datë 22.04.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Këshilli me datë 01.06.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Ankuesi, lidhur me këtë procedurë të rekrutimit ka iniciuar edhe konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 05.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1043/20 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të datës 04.06.2020 dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për ankesën e ankuesit të datës 21.04.2019.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokoll 769/2020 të datës 21/04/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KA.nr. 10/2020 të datës 02/04/2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Ankesën e datës 09/03/2020 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së; Diplomën 31/07/2008, 30/08/2012, 08/10/2012 të ankuesit; Certifikatën e datës 22/05/2019 të ankuesit; Certifikatën 30/08/2015; Vërtetimin e datës 04/07/2013, 10/10/2009 të ankuesit; Letër konfirmimi i datës 18/09/2019; Kontratë për themelimin e marrëdhënies së punës me kohë të caktuar e datës 10/05/2015'

Autorizim i datës 04/01/2018; Letër rekomandimi i datës 12/06/2009; Kontratë mbi vepër e datës 22/12/2008; Vërtetim i datës 22/02/2017; Kontratë mbi vepër e datës 19/02/2016; Vërtetim i datës 06/05/2015; Emailin e datës 21/04/2020 nga ankuesi për [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net); Përmbledhja e Vlerësimeve Individuale; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Raporti Final i Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues; Raporti Përmbledhës; E-maili i datës 21/02/2020 nga Regjistri i aplikacioneve të pranuar; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; Deklaratat për mosekzistim të konfliktit të interesit datës 20/02/2020; Vendimin me Nr. 03/208 i datës 18/02/2020; Propozimin për emërimin e KPSHC-së i datës 18/02/2020; Vendimin me Nr. 03/31 i datës 13/01/2020; Njoftimin e datës 09/01/2020; E-mailin e datës 10/01/2020 dhe 08/01/2020; Shkresën e datës 25/10/2019; Konkursin e datës 16.09.2019 të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për pozitën "Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional" në Gjykatën Themelore në Prizren; Autorizimi i DASHC/MAP i datës 10.09.2019; Formularët e vlerësimit individual të ankuesit dhe kandidatit Procesverbali i takimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve he Ankesave të SKGJK-së i datës 02/04/2020; Ankesën e datës 04/03/2020 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së; Testi me shkrim i ankuesit dhe kandidatit i datës 24/02/2020; Kërkesën për punësim e datës 23/09/2019 të ankuesit me diplomat, certifikatat dhe vërtetimet e lartcekura; Kërkesën për punësim e datës 30/09/2019 të kandidatit Diplomën e datës 30/10/2013 dhe 21/05/2015 të kandidatit Certifikatën e datës 23/09/2019 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren; Certifikatën e datës 15/04/2019; Kontratë të Shërbimeve; Kontratë pune për periudhën të pacaktuar kohore e datës 03/01/2018; Njoftim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës datë 27/05/2019; Aneks marrëveshje i datës 16/08/2017 dhe 30/01/2017; Marrëveshje për kryerjen e shërbimeve të veçanta e datës 28/07/2016; Kontratë pune e datës 09/11/2017; Vërtetim i datës 03/06/2015, 01/02/2018; Letër Rekomandim i datës 12/11/2017; Letër Reference e datës 16/03/2015; Certifikatën e datës 07/12/2017; Falënderim datë 29/12/2016; Certifikatë 2016; Njoftim lidhur me ankesën i datës 04/06/2020 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për ankuesin; Aktgjykimin A.nr.1043/20 të datës 05.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Kolegji, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se kandidati i përzgjedhur në këtë pozitë të punës nuk i plotëson kushtet e konkursit, respektivisht përvojën e punës, dhe se i njëjti është favorizuar pasi që ka ardhur i fundit dhe është larguar i pari nga vendi ku është mbajtur testi. Ankuesi me tutje pretendon se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në mënyrë të kundërligjshme ka nxjerr vendim për refuzimin e ankesës së tij.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se kandidati i përzgjedhur nuk i ka plotësuar kushtet e konkursit, gjegjësisht kriterin e përvojës së punës, ka shqyrtuar shkresat e lëndës, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se kriteret e konkursit për pozitën Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në Gjykatën Themelore të Prizrenit, kanë qenë: 1. Diplomë e fakultetit juridik; 2. Tre (3) vite përvojë punë në lëmin juridik; dhe 3. Provimin e dhënë të Jurisprudencës. Kolegji, përkitazi me këtë ka analizuar dosjen e ankuesit si dhe dosjen e kandidatit

të përzgjedhur dhe si rrjedhojë ka konstatuar se të dy kandidatët kanë plotësuar kushtet e përcaktuar në konkurs rrjedhimisht Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil gjatë vlerësimit të aplikacioneve ka zbatuar drejtë dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 ku përcaktohet se: *Anëtar e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve si në vijim: arsimimi dhe kualifikimi profesional*, andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se kandidati i përzgjedhur është favorizuar pasi që ka ardhur i fundit dhe është larguar i pari nga vendi ku është mbajtur testi, Kolegji konstaton se në bazë të provave të lëndës i njëjti pretendim nuk ka mundur të vërtetohet me asnjë provë nga ankuesi, sepse nuk ka asnjë dëshmi që ndonjë nga kandidatët në këtë procedurë të jetë favorizuar, sepse sipas shkresave të lëndës të gjithë kandidatëve i është dhënë mundësia e barabartë për të treguar aftësitë e tyre në testin me shkrim dhe me gojë, në këtë rast Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar kandidati i përzgjedhur pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë është vlerësuar me 438.50 pikë, ndërsa ankuesi është renditur i dyti me 428.50 pikë, kështu që në shërbimin emërohen kandidatët që kanë numërim më të madh të pikëve sipas nenit 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë"*, po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se procedura e rekrutimit për pozitën "Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional" për Gjykatën Themelore në Prizren është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në mënyrë të kundërligjshme ka nxjerr vendim për refuzimin e ankesës së tij, Kolegji duke iu referuar shkresave të lëndës, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KA.nr.10/2020 të datës 02/04/2020, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.168/2021

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

